

## RELACION

### PËR

## PROJEKTVEKNDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

### PËR

## MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË 2024 - 2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Zhvillimi i politikave në fushën e marrëdhënieve të punës, dialogut social, sigurisë, shëndetit dhe inspektimit të punës, janë disa ndër përgjegjësitë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga këto përgjegjësi, është i nevojshëm zhvillimi i politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë, konkretisht është domosdoshmëri hartimi i një “Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ri, për të ardhmen.

Garantimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, kërkon kontributin e shumë faktorëve si: institucioneve politikbërëse dhe ligjzbatuese, përgjegjëse për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të jashtëm dhe vendas në fushën e marrëdhënieve të punës, etj.

Një vizion i qartë për të ardhmen, i zbërthyer në politika, objektiva strategjike dhe masa të mirëpërcaktuara, të cilat mund të zbatohen në mënyrë efektive, duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nuk mund të arrihet pa kontributet e faktorëve, institucionalë ose jo, që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Projektvendimi i propozuar ka si qëllim miratimin e “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”.

“Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, ka për qëllimin vazhdimin e reformave të fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në botën e punës gjatë viteve të zbatimit të dokumentit të mëparshëm “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016-2020”.

Objektivi kryesor i këtij Dokumentit Politik është të drejtojë vendin drejt nxitjes së respektit dhe arritjes progresive të së drejtës themelore, për një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm dhe si rezultat përmirësimin e produktivitetit dhe forcimin e ekonomisë kombëtare. Ai synon të përmirësojë mjedisin e punës, duke zbutur në këtë mënyrë numrin e aksidenteve dhe sëmundjeve në punë nëpërmjet zbatimit të një qasjeje parandaluese, sistematike dhe të mirëkoordinuar për menaxhimin e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, duke kultivuar një kulturë parandaluese të sigurisë dhe shëndetit.

Për të realizuar këtë objektiv gjithëpërfshirës, Dokumentit Politik i propozuar mbështetet nga tre shtylla themelore:

*Shtylla A:* Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme.

*Shtylla B:* Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte pune të denja.

*Shtylla C:* Kthimi në prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushtet e punës së denjë.

Nga objektivi i përgjithshëm, janë identifikuar dhe synohet të arrihen katër rezultate kryesore:

- Realizimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore.
- Përmirësimi i mjedisit të punës duke zbatuar një qasje parandaluese, sistematike dhe të mirëkoordinuar për administrimin e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Ulja e shkallës së aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.
- Nxitja e një kulture parandaluese të sigurisë dhe shëndetit.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Hartimi i këtij dokumenti është në përputhje me vizionin dhe prioritetet e Qeverisë të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030”, (*miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023*) me “Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024” (*miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023*), me kornizën strategjike të BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë, me dy Konventat Themelore të ILO-s për SSHP: Konventa nr. 155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981”, (*ratifikuar me Ligjin nr. 9147, datë 30.10.2003*) dhe Konventës C187 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për kuadrin promociional të sigurisë dhe të shëndetit në punë”, 2006”, (*ratifikuar me Ligjin nr. 4/2014*), si dhe në “Strategjinë Globale për Shëndetin në Burimet Njerëzore, Fuqia punëtore 2030”, të OBSH-së.

Gjithashtu, në kuadër të Kapitullit 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”, si dhe të rekomandimeve të “Raportit të Progresit për Shqipërinë, 2023”, del i nevojshëm hartimi i këtij dokumenti.

Hartimi i “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2024 - 2030 dhe të Planit të Veprimit”, është pjesë e Programit Analitik të Akteve të Këshillit të Ministrave nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për vitin 2024.

Në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030”, nuk është përfshirë hartimi i një strategjie për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por ajo konsiderohet si dokument plotësues strategjik i “Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024”, ndaj dhe forma e hartimit të këtij dokumenti do të jetë “Dokument Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit”.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Njohja e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore është integruar në Strategjinë Globale të ILO-s për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030, pas rezolutës së miratuar në Konferencën e 110-të Ndërkombëtare të Punës , e cila e zyrtarizoi atë si të drejtën e pestë në 1998, “Deklaratën e ILO-s mbi “Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë”. Rrjedhimisht, kombet në mbarë botën i kanë drejtuar përpjekjet e tyre drejt arritjes së këtij qëllimi dhe respektimit të parimeve të përshkruara në dy Konventat Themelore, përkatësisht “Siguria dhe Shëndeti në Punë” - Konventat 155 dhe “Kudri promovues për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” - Konventa 187. Si rezultat, përshtatja e politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe forcimin e institucioneve përgjegjëse për hartimin, krijimin dhe zbatimin e kuadrit normativ, mbeten një sfidë e rëndësishme aktuale dhe e ardhshme për të gjitha vendet.

Gjithashtu, hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti politikash përmbush një nga rekomandimet e dhëna në “Raportin e Progresit për Shqipërinë, 2023”, për Kapitullin 19 “Politikat Sociale dhe të Punësimit”, në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të prioritetëve të Qeverisë të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030”, (*miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023*) në “Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024” (*miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023*).

Dokumenti Politik do të krijojë një vizion të qartë për të ardhmen, të zërthyer në politika, objektiva strategjike dhe masa të mirëpërcaktuara, të cilat mund të zbatohen në mënyrë efektive, duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të Sigurisë Shëndetin në Punë.

Në qendër të këtij dokumenti politikash është bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të gjitha ministrive të linjës, agjencive qeveritare, punëdhënësve, punonjësve dhe organizatave të tyre përfaqësuese dhe aktorëve të tjerë kyç. Kjo përpjekje kolektive siguron përdorimin optimal të burimeve publike, minimizon kostot e pajtueshmërisë për punëdhënësit dhe nxit udhëheqjen e qëndrueshme të koordinimit.

#### *Rezultatet e pritshme*

- Rritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Korniza normative të përmirësuara për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- Krijimi i sistemeve të monitorimit për pasojat në vendin e punës.
- Forcimi i sistemeve të njohjes dhe raportimit për sëmundjet profesionale.
- Mekanizmat e çertifikimit për profesionistët e SSHP.

#### *Rezultatet afatshkurtra*

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të të drejtave dhe parimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Përmirësimi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës.

- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të SSHP përmes mekanizmave të certifikimit.

#### *Rezultatet e ndërmjetme*

- Ulja e shkallës së aksidenteve në punë.
- Ulja e shkallës së sëmundjeve profesionale.
- Përputhshmëri e përmirësuar me rregulloret e sigurisë dhe shëndetit në punë.

#### *Rezultatet afatgjata*

- Krijimi i mjediseve të sigurta dhe të shëndetshme të punës si një e drejtë themelore në nivel global.
- Rënie e konsiderueshme e vdekjeve dhe lëndimeve të lidhura me punën.

Ky dokument politikash dhe plan veprimi është produkt i përpjekjeve ndërsektoriale dhe për rrjedhojë, koordinimi dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i tij do të koordinohen nga të gjitha palët përkatëse të përfshira. Këshilli Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë - KNSSHP do të jetë organi mbikëqyrës i zbatimit të strategjisë, i cili do të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të përfshira në këtë Plan Veprimi për zbatimin e SSHP.

Për çdo objektiv të strategjisë caktohet një institucion përgjegjës, i cili ka rolin e koordinimit me institucionet e tjera të përfshira në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në secilin objektiv.

Do të kryhet një vlerësim afatmesëm (2027) i Dokumentit të Politikës së SSHP dhe Planit të Veprimit për të matur progresin me zbatimin e këtij dokumenti, duke vlerësuar dobinë dhe fizibilitetin e treguesve ekzistues dhe duke zhvilluar tregues të rinj sipas nevojës. Një vlerësim përfundimtar është planifikuar të bëhet në vitin 2030 dhe do të kryhet për të vlerësuar suksesin e përgjithshëm të zbatimit të Planit të Veprimit (efikasiteti dhe efektiviteti), si dhe për të vlerësuar, për aq sa është e mundur, ndikimin e politikave të parashikuara, në dokument.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse, do të merren masa për të siguruar Monitorimin dhe Vlerësimin nga vlerësues të pavarur, veçanërisht Vlerësimi Afatmesëm dhe Përfundimtar.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, gërmës “a”, pika 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Dokumenti politik është në përputhje me prioritetet e Qeverisë të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030”, (*miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023*), në “Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj, si dhe të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore 2023 - 2024” (*miratuar me VKM nr. 173, datë 24.03.2023*).

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në përmbajtjen e tij projektakti përbëhet nga tre pika të cilat parashikojnë *miratimin* e dokumentit politik për SSHP-në, *shfuqizimin* e vendimit që ka miratuar dokumentin politik të mëpërshëm, si dhe *përcaktojnë* institucionet dhe organizmat për zbatimin e tij, konkretisht:

*Pika 1 e projektvendimit parashikon*, miratimin e “Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

*Pika 2 e projektvendimit shfuqizon*, Vendimin nr. 371, datë 18.5.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2016 - 2020 dhe Planit të Veprimit të zbatimit të tij”.

*Pika e 3 e projektvendimit përcakton*, ministritë e linjës dhe institucionet për ndjekjen dhe zbatimin e planin e veprimit të Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

### ***Dokumenti i Politikave - Përmbajtja***

Ky dokument përbëhet nga 5 kapituj, Plani i Veprimit dhe disa anekse si më poshtë:

- Kapitulli 1: Politikat e sigurisë dhe shëndetit në punë
- Kapitulli 2: Vizioni dhe përparësitë strategjike
- Kapitulli 3: Objektivat e politikave
- Kapitulli 4: Kostot e vlerësuara dhe burimet e financimit
- Kapitulli 5: Mekanizmat e llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit
- Plani i Veprimit
- Aneksë

Për të realizuar objektivin gjithëpërfshirës, Dokumenti i Politikave mbështetet në tre shtyllat themelore të cilat zërthehen në:

- Prioritetet strategjike
- Treguesit e ndikimit
- Objektivat strategjike
- Aktivitetet/ Veprimet

### ***Shtylla A: Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe ato të ardhshme.***

Shtylla strategjike A synon të trajtojë peisazhin në zhvillim të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës duke siguruar që kuadri rregullator dhe strukturat institucionale të mbeten të përgjegjshme dhe elastike ndaj sfidave aktuale dhe të ardhshme. Kjo shtyllë pranon se bota e punës, së bashku me kërcënimet aktuale dhe ato në zhvillim të lidhura me rreziqet e sigurisë

dhe shëndetit, është një fushë në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të ndryshimeve teknologjike dhe ekonomike, ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike.

### ***Prioriteti Strategjik A1: Përmirësimi i kuadrit ligjor të SSHP***

Përmirësimi i i kuadrit ligjor të SSHP-së kërkon krijimin e një Këshilli Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (KNSSHP), siç përcaktohet nga Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ky këshill do të bashkërendojë dhe nxisë bashkëpunimin e aktorëve kryesorë në këtë fushë. Njohja e mangësive në përpjekjet bashkëpunuese si një pengesë kritike për zbatimin e strategjisë së mëparshme nënvizon nevojën për një mekanizëm të fuqishëm Monitorimi dhe Vlerësimi. Ky mekanizëm, i lehtësuar nga angazhimi aktiv i të gjithë aktorëve, siguron një ekzekutim efektiv të strategjisë për SSHP.

*Objektivi A1.1:* Ngritja dhe funksionimi i rregullt i Këshillit Ndërmintor për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (KNSSHP), siç përcaktohet nga Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

*Objektivi A1.2:* Përafrimi i kuadrit rregullator të vendit për procesin e anëtarësimit në BE

### ***Prioriteti Strategjik A2: Përmirësimi i sistemeve të hetimit dhe raportimit të aksidenteve dhe sëmundjeve***

Krijimi i një sistemi të fortë për hetimin dhe raportimin e aksidenteve në punë është i domosdoshëm për të ruajtur sigurinë në vendin e punës dhe për të parandaluar incidentet e ardhshme. Aktualisht, efektiviteti i sistemit ekzistues të raportimit dhe regjistrimit pengohet nga pengesa të ndryshme.

*Objektivi A2.1:* Zhvillimi i një Regjistri Kombëtar të Aksidenteve dhe Sëmundjeve Profesionale (RKASP) bazuar në kërkesat ESAW<sup>1</sup> dhe EODS<sup>2</sup>

### ***Prioriteti Strategjik A3: Krijimi i një sistemi për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ekspertëve dhe shërbimeve të SSHP***

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) dhe ekspertiza e profesionistëve brenda kompanive është thelbësore për kultivimin dhe sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune dhe rrit produktivitetin. Një mjedis pune i sigurt dhe i shëndetshëm ka një ndikim kritik në mirëqenien e fuqisë punëtore dhe qëndrueshmërinë e mjedisit të punës, praktikat e përmirësuara të SSHP reduktojnë kostot operacionale dhe mungesat, duke rritur produktivitetin dhe reputacionin e organizatës.

*Objektivi A3.1:* Zbatimi i Programit të Trajnimit dhe Sistemi i Regjistrimit i krijuar dhe funksionuar për certifikimin e profesionistëve të SSHP dhe licencimin e shërbimeve

### ***Shtylla B: Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte pune të denja***

---

<sup>1</sup> Statistikat Evropiane për Aksidentet në Punë (ESAW) janë burimi kryesor i të dhënave për statistikat e BE-së në lidhje me çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë.

<sup>2</sup> Statistikat Evropiane të Sëmundjeve Profesionale (EODS) janë elementë thelbësorë në strategjinë e KE-së për të vlerësuar efikasitetin e legjislacionit të Komunitetit për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Përpjekjet për të forcuar qeverisjen dhe menaxhimin e institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP) janë thelbësore në nxitjen e kushteve të mira të punës për të gjithë, mbrojtjen e shëndetit dhe të drejtave të punëtorëve, promovimin e produktivitetit ekonomik, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe etike dhe ruajtjen e përgjegjësisë sociale.

***Prioriteti Strategjik B1: Forcimi i kapaciteteve të institucioneve politikëbërëse dhe zbatuese***

*Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: Sektori i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë*

Aktualisht, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, çështjet e zhvillimit dhe monitorimit të politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe inspektimin e punës mbulohen nga një sektor i dedikuar për këto çështje. Forcimi i kësaj strukture është i domosdoshëm për përmbushjen e detyrimeve në procesin e integritit evropian të Shqipërisë, detyrimeve në kuadër të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), etj.

*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Sektori i Shëndetit dhe Mjekësisë në Punë*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe institucionet e lidhura me të, duke përfshirë Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) dhe Inspektoratin Shtetëror të Shëndetësisë (ISHSH), kanë nevojë për përmirësime thelbësore në qasjen e tyre ndaj shëndetit dhe sigurisë në punë. Aktualisht, ka mungesë të strukturave të përcaktuara brenda MSHMS-së të ngarkuara posaçërisht për trajtimin e shëndetit në punë, duke rezultuar në probleme me kujtesën institucionale dhe kujdesin e fragmentuar brenda shërbimeve shëndetësore parësore. Për të adresuar këto mangësi, është thelbësore të krijohet një strukturë e dedikuar përgjegjëse për shëndetin dhe mjekësinë në punë brenda MSHMS dhe institucioneve në varësi të saj.

*Objektivi B1.1:* Rritja e kapaciteteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për SSHP

*Objektivi B1.2:* Zhvillimi dhe zbatimi i kurseve për SSHP dhe programeve të trajnimit në shëndetin në punë

***Prioriteti Strategjik B2: Rritja e kapaciteteve të institucioneve zbatuese***

*Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)*

Në koordinim me nismën e Qeverisë së Shqipërisë për reformimin e inspektorateve, nevojiten disa veprime për të siguruar që inspektimi i punës të jetë ende në përputhje me kërkesat e Konventave të qeverisjes së ILO-s 81, Inspektimi i Punës, dhe 129, Inspektorati i Punës në Bujqësi, të dyja të ratifikuara nga Shqipëria dhe për Forcimin e efektivitetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISSHPSH).

*Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)*

Ashtu si inspektimi i punës, inspektimi shëndetësor duhet t'i përshtatet strukturës së re të inspektimit të miratuar nga vendi. Megjithatë, në vend që të ndjekë të njëjtat hapa si ato të parashikuara për ISHPSHSH, inspektimi shëndetësor duhet të pajiset me mjete dhe trajnime për të trajtuar më mirë çështjet që lidhen me sëmundjet profesionale dhe, mbi të gjitha, për të adresuar masat e nevojshme parandaluese.

*Objektivi B2.1:* Kapacitete të zgjeruara të ISHPSHSH

*Objektivi B2.2:* Kapacitete të zgjeruara të ISHSH

***Prioriteti Strategjik B3: Përmirësimi i Dialogut Social në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë***

Promovimi i dialogut të fuqishëm social në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë (SSHP) është thelbësor për të garantuar mirëqenien e punëtorëve dhe për të nxitur një mjedis të sigurt pune. Krahas krijimit të Komitetit Ndërministror (KN), me pjesëmarrjen e punëtorëve dhe punëdhënësve, është thelbësore që të shikohen nga afër sektorët ekonomikë ku mbizotërojnë aksidentet dhe sëmundjet në punë, veçanërisht ngjarjet më të rënda, në sektorë të tillë si. Ndërtimi, Bujqësia, Minierat dhe Transporti. Krahas rrezikshmërisë së lartë të veprimtarisë së tyre, këta sektorë shpesh paraqesin probleme të veçanta në lidhje me marrëdhëniet e punës.

*Objektivi B3.1:* Ngritja e Komiteteve “ad-hoc” trepalëshe specifike për sektorin dhe promovimi i funksionimit të rregullt të komiteteve të SSHP në nivel ndërmarrje

***Shtylla C: Kthimi në prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushtet e punës së denjë.***

Në kërkimin për të siguruar kushte të mira pune dhe për t'i dhënë përparësi Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP), një qasje e shumëanshme është thelbësore. Në qendër të kësaj përpjekjeje është promovimi i një kulture parandaluese nëpërmjet shpërndarjes së gjerë të informacionit dhe ndërgjegjësimit. Duke i pajisur punëtorët, punëdhënësit dhe përfaqësuesit e tyre me njohuri për rreziqet e mundshme dhe protokollat e sigurisë, ata fuqizohen për të zbutur në mënyrë aktive rreziqet dhe për të mbrojtur mirëqenien e tyre në vendin e punës.

***Prioriteti Strategjik C1: Promovimi i një kulture parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nëpërmjet shpërndarjes së informacionit dhe ndërgjegjësimit***

Promovimi i një kulture parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë është një nga dy shtyllat e Konventës 187 të ILO-s, si dhe aplikimi në nivel kombëtar i një përjasjeje të menaxhimit të sistemeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke ruajtur mirëqenien e punonjësve dhe të materializojë një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm si një e drejtë themelore. Shpërndarja gjithëpërfshirëse e informacionit dhe nismat për rritjen e ndërgjegjësimit synojnë të rrenjosin një qasje proaktive ndaj sigurisë dhe shëndetit në punë.

*Objektivi C1.1:* Promovimi i një kulture parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

***Prioriteti Strategjik C2: Bërja e arsimit për SSHP prioritet në të gjitha nivelet/ Prioriteti i arsimit për SSHP në të gjitha nivelet arsimore***

Veprimet që synojnë vendin e punës janë thelbësore, por krijimi i një kulture SSHP duhet të përfshijë domosdoshmërisht diskutimin dhe promovimin e kësaj teme në shkolla. Do të zbatohen disa nisma për të promovuar një kulturë të parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale në të gjitha nivelet arsimore, duke përfshirë domosdoshmërisht trajnimin e mësuesve.



Për të adresuar këtë, do të ndërmerren iniciativa gjithëpërfshirëse në nivele të ndryshme arsimore për të siguruar trajnim dhe ndërgjegjësim adekuat.

*Objektivi C2.1:* Integrimi i SSHP në të gjitha nivelet e shkollimit, formimit profesional dhe arsimit të lartë.

### ***Plani i Veprimit - Përmbajtja***

Plani i Veprimit përmban tre shtyllat themelore të zërthyerë në:

- Prioritetet strategjike
- Treguesit e ndikimit
- Objektivat strategjike
- Aktivitetet/Veprimet

Plani i Veprimit paraqet në mënyrë grafike rubrikat si më poshtë:

- Aktiviteti dhe Rezultati, Veprimtaria dhe përfundimi
- Institucioni përgjegjës
- Afati kohor
- Burimi financiar
- Konteksti dhe problematika
- Objektivi afatmesëm
- Objektivi i synuar

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet dhe organet që ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e planin e veprimit të Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, janë:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;  
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;  
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;  
Ministria e Arsimit dhe Sportit;  
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;  
Ministria e Financave;  
Këshilli Ndërmnistror i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë; *(i cili do të ngrihet sipas PV)*  
Inspektorati Qëndror;  
Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;  
Instituti i Sigurimeve Shoqërore;  
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;  
Instituti Shëndetit Publik;  
Inspektori Shtetëror Shëndetësor;  
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;  
Instituti i Statistikave (INSTAT);  
Universiteti Politeknik i Tiranës;  
Universiteti i Mjeksisë, Fakulteti i Mjeksisë, Tiranë;  
Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit;

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;  
Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP/ILO);  
Organizatat e Punëdhënësve dhe Punëmarrësve.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është hartuar nga struktura përgjegjëse për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ndërsa hartimi i “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, është realizuar nga Grupit Ndërinstitucional të Punës, i ngritur në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 108, datë 08.09.2023 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e “Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2023 - 2030 dhe Planit të Veprimit”, në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ONP/ILO dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë OBSH/WHO.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës të angazhuar në hartimin e këtij dokumenti janë kryesisht përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e tyre të varësisë si: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - ISHPSHSH, Instituti i Sigurimeve Shoqërore - ISSH, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive - AKPA, Instituti i Shëndetit Publik - ISHP dhe Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor - ISHSH.

Kanë kontribuar edhe përfaqësues të disa ministrive të linjës si të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë e Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve si: Instituti i Statistikve - INSTAT, Universiteti Politeknik i Tiranës – UPT dhe Universiteti i Mjekësisë.

Gjithashtu, kanë kontribuar edhe përfaqësues të Partnerëve Socialë (organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve) si: Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë - BSPSH, Kofederata e Sindikatave të Shqipërisë - KSSH dhe BiznesAlbania.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, është asistuar gjatë punës së tij nga Sekretariati Teknik, i cili përbëhet nga specialistë të Drejtorisë së Marrëdhënieve të Punës, Sigurisë dhe Shëndetit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit, do të publikohet për konsultim publik dhe do të dërgohet për mendim në ministritë e linjës dhe institucionet e përfshira.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektakti shoqërohet me efekte financiare, sa i takon zbatimit të Planit të Veprimit për Dokumentin Politik për SSHP-në 2024 - 2030. Burime kryesore për financimin e planit të veprimit do të jenë:

- Buxhetet e vlerësuara dhe të miratuara për ministrinë përkatëse dhe programet buxhetore, të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026
- Kontributi i donatorëve potencialë që operojnë në fushën e SSHP në vend.

Gjetja e burimeve të ndryshme të financimit për mbulimin e kostos së përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për SSHP-në, është një element kyç.

Kostot e parashikuara dhe shkalla e mbulimit me fonde nga dy burimet kryesore për financimin e Planit të Veprimit për SSHP 2024 - 2030, do të mundësojnë identifikimin e hendekut financiar për sa i përket shumave dhe burimeve të financimit për çdo veprim, për çdo objektiv, si dhe hendekun e përgjithshëm në financimin e planit të veprimit.

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e kostos së Planit të Veprimit për SSHP-së bazohet në metodën e kostos së bazuar në aktivitetet.

Kjo metodë vlerëson kostot e mundshme si një proces me dy faza:

- kostot nga burimet tek aktivitetet, dhe
- kostot nga aktivitetet tek objektivat.

Kostot e vlerësuara për çdo aktivitet llogariten bazuar në tre kategori kryesore:

- kostoja e përsëritur;
- burimet njerëzore;
- investimi.

Kostot e parashikuara të përfshira në Planin e Veprimit do të rishikohen të paktën çdo dy vjet për të identifikuar deri në çfarë mase do të jetë e mundur të mobilizohen alokime shtesë nga buxheti i shtetit për politikën e SSHP-së, si dhe kontributet e donatorëve të ardhshëm. Analiza e kostove të vlerësuara dhe burimeve të financimit do të kryhet në vitin 2027 në kuadër të rishikimit afatmesëm të zbatimit të Dokumentit Politik për SSHP-në.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI I EKONOMISË, KULTURËS  
DHE INOVACIONIT**

**BLENDI GONXHJA**